



A.nr.1/2024

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët, Hajriz Hoti kryesues, Burim Ademi, Kymete Kicaj, Franciska Zhitija-Ymeri, dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesat e përfaqësuesve të subjektit politik nga Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, të parashtruar nga Alim Rama, Qëndrim Krasniqi qendra në Britani të Madhe, Fahri Beqa qendra në Gjermani, Zenel Zeneli qendra në Suedi, Qëndresa Sadriu qendra në Zvicër, Kastriot Gjoni qendra në Francë, Edmond Pruthi qendra në SHBA, Kaltrina Lajçi qendra në Norvegji, dhe Bernarda Radoncic qendra në Danimarkë, të paraqitur kundër vendimit të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr. 01/1305-2024, të datës;29.08.2024, për miratimin e listës së qendrave të votimit jashtë Kosovës, numrin e vendvotimeve dhe numrin maksimal të votuesve, në seancën e panelit të mbajtur me datë;03.09.2024, merr këtë,

V E N D I M

Hedhen poshtë të palejuara ankesat e përfaqësuesve të subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë A.nr.1/2024, e datës;31.08.2024, e parashtruar nga Alim Rama, A.nr.2/2024, e datës;31.08.2024, e parashtruar nga Qëndrim Krasniqi, qendra në Britani të Madhe, A.nr.3/2024, e datës;31.08.2024, e parashtruar nga Fahri Beqa, qendra në Gjermani, A.nr.4/2024, e datës;31.08.2024, e parashtruar nga Zenel Zeneli, qendra në Suedi, A.nr. 5/2024, e datës;31.08.2024, e parashtruar nga Qëndresa Sadriu, qendra në Zvicër, A.nr.6/2024, e datës;01.09.2024, e parashtruar nga Kastriot Gjoni, qendra në Francë, A.nr.7/2024, e datës;31.08.2024, e parashtruar nga Edmond Pruthi, qendra në SHBA, A.nr.8/2024, e datës;31.08.2024 e parashtruar nga Kaltrina Lajçi, qendra në Norvegji, A.nr.9/2024, e datës;01.09.2024 e parashtruar nga Bernarda Radoncic, qendra në Danimarkë, me të cilën kanë kërkuar që vendimi i KQZ-së Nr.01/1305-2024, i datës;29.08.2024, lidhur me vendimin për miratimin e listës së qendrave të votimit jashtë Kosovës, numrin e vendvotimeve dhe numrin maksimal të votuesve, të shpallet i pavlefshëm, dhe të urdhërohet KQZ që të veprojë sipas Nenit 96, paragrafi 8 i LZP, duke hequr kufizimin e tillë të numrit maksimal të votuesve në qendrat e votimit jashtë Kosovës, si dhe të nxjerrë vendim meritor, të arsyetuar në lidhje me këtë çështje në bashkëpunim me MPJD.

A r s y e t i m

Me datë;31.08.2024, dhe datë;01.09.2024, PZAP-i, ka pranuar ankesat e paraqitura nga përfaqësuesit e subjektit politik Alim Rama nga Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, Qëndrim Krasniqi qendra në Britani të Madhe, Fahri Beqa qendra në Gjermani, Zenel Zeneli qendra në Suedi, Qëndresa Sadriu qendra në Zvicër, Kastriot Gjoni qendra në Francë, Edmond Pruthi qendra në SHBA, Kaltrina Lajçi qendra në Norvegji, Bernarda Radoncic qendra në Danimarkë, të parashtruar kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.01/1305-2024, të datës;29.08.2024, me të cilën pretendojnë se KQZ me datë 29 Gusht 2024, në mbledhjen e 46 për vitin 2024, ka marrë vendim për Miratimin e Listës së Qendrave të Votimit Jashtë Kosovës, Numrin e Vendvotimeve dhe Numrin Maksimal të Votuesve ku në pikën I të Vendimit thuhet: "Miratohet lista e qendrave të votimit jashtë Kosovës, numri i vendvotimeve dhe numri maksimal i votuesve, për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikën së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025."

Parashtruesit e ankesës theksojnë se bazuar në nenin 119, paragrafi 5 të LZP, duke pasur parasysh rëndësinë e çështjes së ngritur, për të “parandaluar një padrejtësi serioze”, duke e konsideruar si çështje “rreptësisht të domosdoshme”, e cila bie “nën juridiksionin e tij”, palët ankuese kërkojnë nga PZAP që të shqyrtojë këtë çështje, pasi që bazuar në nenin 96, par. 8 i LZP, i cili citon: “KQZ-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, vlerëson hapësirat fizike për secilën përfaqësi diplomatike dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara, merr vendim për numrin e vendvotimeve dhe për numrin e votuesve për secilën përfaqësi diplomatike, jo më vonë se pesë (5) ditë nga dita e shpalljes së datës së zgjedhjeve, ku KQZ kërkon nga MPJ, listën e të gjitha përfaqësive diplomatike, bashkë me detajet e nevojshme mbi hapësirën e objekteve, e ku Ministria e Punëve të Jashtme obligohet që t’i ofrojë KQZ-së të gjitha informacionet e kërkuara brenda tre (3) ditë, nga dita e pranimit të kërkesës. MPJ përshtat hapësirat e objekteve të përfaqësive diplomatike në vendvotime sipas kriterëve të përcaktuara nga KQZ.”

Rrjedhimisht, në hapin e parë, vlerësimin e hapësirave fizike për secilën përfaqësi diplomatike, KQZ e bën në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ) dhe vetëm në hapin e dytë, KQZ, po ashtu në bashkëpunim me MPJ, merr vendim për numrin e vendvotimeve dhe të votuesve.

Parashtruesit e ankesave theksojnë se me këtë vendim KQZ ka bërë gabim në hapa pasi që nuk ka marrë parasysh veprimet dhe zotimet ligjore të MPJ në këtë drejtim dhe rrjedhimisht ka marrë vendim në mënyrë të njëanshëm dhe arbitrar.

Prandaj sipas parashtruesve të ankesës sipas kërkesës ligjore të nenit 96, par 8 të LZP, MPJ brenda afateve ligjore i ka dërguar KQZ përmes emailit, por edhe në takimet fizike, listën e qendrave të votimit me numrin e votuesve që mund të votojnë në ato qendra të votimit jashtë Kosovës ku MPJ, brenda afatit të paraparë ligjor sipas paragrafi 8 të Nenit 96 të LZP, MPJ është përgjegjës në kërkesën e KQZ. Krahas kësaj, MPJ përmes emailit, më 26 gusht 2024 ka përcjellë në KQZ edhe listën e të gjitha përfaqësive diplomatike të Republikës së Kosovës dhe numrin e mundshëm të votuesve që mund të votojnë në hapësirat e këtyre përfaqësive diplomatike të cilat, bazuar në kompetencat dhe të drejtat që rrjedhin sipas të Drejtës Ndërkombëtare (Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike e vitit 1961), garanton se mund të sigurohen nga MPJ brenda afateve të përshtatshme ligjore, si dhe një pasqyrë të të gjitha përfaqësive diplomatike të Republikës së Kosovës.

Parashtruesit e ankesave theksojnë se nisur nga këto fakte konkrete, shihet qartë se nxjerrja e vendimit nga KQZ nuk është bërë në bashkëpunim me MPJ ashtu siç kërkon Neni 96, par. 8 i LZP-së, prandaj vendimi i KQZ është arbitrar, i kundërligjshëm, i paarsyetuar dhe diskriminues në raport me votuesit jashtë Kosovës, pasi që e drejta e votës është e drejtë e garantuar me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Dhe se askush nuk ka të drejtë të kufizojë këtë të drejtë, përveç kur kjo kufizohet me vendim gjyqësor.

Parashtruesit e ankesave kërkojnë nga PZAP, që të shpallë të pavlefshëm vendimin Nr. 01/1305-2024, të datës;29.08.2024, dhe të urdhërojë KQZ që të veprojë sipas Nenit 96, par. 8 i LZP, duke hequr kufizimin e tillë të numrit maksimal të votuesve në qendrat e votimit jashtë Kosovës, si dhe të nxjerrë vendim meritore, të arsyetuar në lidhje me këtë çështje në bashkëpunim me MPJD.

Si dëshmi kanë bashkangjitur shtojcat: vendimi i KQZ, i datës;29.08.2024, Qendrat e votimit në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës, për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës që mbahen me 9 shkurt 2025, emaila të dërguar nga MPJD më 28 gusht 2024 në adresë të KQZ, MPJD - Propozim lista për KQZ, Lista e profilit teknik të përgjithshëm të objekteve, Email i dërguar nga KQZ në MPJD më 26 gusht 2024.

Në përgjigjen në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sqaron gjithë ecurinë e procesit të zhvilluar nga ana e saj duke theksuar në mbledhjen e saj ka caktuar numrin maksimal të votuesve në

çdo përfaqësi diplomatike duke u mbështetur në kapacitetin e secilës përfaqësi diplomatike, ku të dhënat për kapacitetet fizike të ambasadave dhe konsullatave janë dërguar nga MPJD, ku sipas KQZ-së numri maksimal i bashkatdhetarëve që mund të regjistrohen për të votuar në një vendvotim është 1000, dhe sipas vlerësimeve të kapaciteteve fizike të përfaqësive diplomatike, votimi do të organizohet në 35 përfaqësi diplomatike në 22 shtete. Në përgjigjen e saj KQZ thekson se me qëllim të pjesëmarrjes të sa më shumë votuesve në procesin zgjedhor të votuesve që jetojnë jashtë vendit ka paraparë ofrimin e tri mundësive, votimi me postë në kutitë postare të hapura nga KQZ-ja jashtë vendit (në misione diplomatike); dhe votimi me postë në kutinë postare të KQZ-së. Në përgjigjen e saj sqaron se votimi fizik në përfaqësi diplomatike, në bazë të ligjit, është përcaktuar të bëhet pas shndërrimit të misioneve diplomatike apo hapësirave të tyre si qendra të votimit, por në bazë të kriterëve që përcaktohen nga KQZ-ja, duke u bazuar në dispozitat ligjore që mundësojnë një proces zgjedhor të drejtë dhe efikas, pa u cenuar qytetarëve e drejta e votimit të lirë. Ka theksuar se sipas KQZ-së me nenin 96, paragrafin 8, të LZP vendimi për numrin e vendvotimeve dhe për numrin e votuesve për secilën përfaqësi diplomatike e merr KQZ-ja, derisa me MPJD-ja bënë vetëm vlerësimin e përbashkët të hapësirave fizike. Rregullorja për Votimin Jashtë Kosovës, në nenin 3, paragrafi 7, ka paraparë që në bazë të vlerësimit të kapaciteteve për votim në përfaqësi diplomatike, KQZ përcakton numrin maksimal të votuesve për secilën përfaqësi diplomatike, të caktuar si qendër votimi, kurse, paragrafi 8 i Rregullores për Votimin Jashtë Kosovës, e ka paraparë mundësinë e plotësimit të numrit të caktuar dhe si duhet të veprohet pasi të arrihet numri maksimal i votuesve në përfaqësi diplomatike. Në këtë rast, aplikuesi do të udhëzohet për mënyrat tjera të votimit. Prandaj, mbi bazën e këtyre dispozitave dhe rrethanave në fjalë, KQZ-ja pa vonesa në mbledhjen nr.46/2024 të datës;29.08.2024, ka miratuar listën e Qendrave të Votimit jashtë Kosovës, në atë mënyrë që respektohet kriteri sipas kapaciteteve fizike të përfaqësive diplomatike dhe që garantohet që publikimi i listave do të bëhet në atë mënyrë që u mundëson qytetarëve sa më parë ushtrimin e të drejtës ligjore për aplikim për regjistrim si votues jashtë vendit. Si dëshmi ka bashkangjitur vendimin e KQZ-së, Nr.01/1305/2024, të datës;29.08.2024, për Miratimin e Listës së Qendrave të Votimit Jashtë Kosovës, Numrin e Vendvotimeve dhe Numrin Maksimal të Votuesve.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.1/2024 i datës 31.08.2024, A.nr.2/2024 i datës 31.08.2024, A.nr.3/2024 i datës 31.08.2024, A.nr.4/2024 i datës 31.08.2024, A.nr.5/2024 i datës 31.08.2024, A.nr.6/2024 i datës 01.09.2024, A.nr.7/2024 i datës 31.08.2024, A.nr.8/2024 i datës 31.08.2024, A.nr.9/2024 i datës 01.09.2024, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.1/2024, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesve.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesave të parashtruara nga ankuesit, vëren se të njëjtat janë të pa lejuara.

Për të vlerësuar lejueshmërinë e paraqitjes së ankesave të ankuesve, paneli iu referuar Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht, nenit 119 paragrafi 3, me të cilin është përcaktuar se "PZAP-i vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj." Ndërsa kundër të cilave vendime të KQZ-së mund të ushtrohet ankesë është specifikuar me nenet, 27.6, 39.3, 41.5, 46, 51.4, 54.8, 69.7, 77.5, 80.3, 94.2, 98.3, 100.3, 102.1, 103.4 dhe 105.1, si dhe ato të cilat janë të përcaktuara në nenin 9, të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave.

Sipas vlerësimit të Panelit, nga interpretimi i dispozitave të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nuk përcaktohet me asnjë dispozite ligjore se mund të

ankimohen vendimet e kësaj natyre të KQZ-së, përkatësisht, vendimi i KQZ-së për Miratimin e Listës së Qendrave të Votimit Jashtë Kosovës, Numrin e Vendvotimeve dhe Numrin Maksimal të Votuesve, në këtë kuptim, paneli vlerëson se rasti lëndor nuk hynë në kategorinë e vendimeve të KQZ-së të cilat mund të ankimohen në PZAP, e rrjedhimisht nga kjo edhe ankesat janë të palejueshme.

Pretendimet e parashtruesve të ankesave në të cilën kërkohet që të shqyrtohen këto ankesa duke u bazuar në nenin 119, par. 5, Paneli vlerëson se kjo dispozitë ligjore nuk krijon juridiksion për shqyrtimin e ankesave nga Paneli për sa i përket vendimit të kësaj natyre, kur nuk është paraparë shprehimisht ankesa ndaj vendimit të KQZ-së, por sqaron qartë se duhet të shqyrtohen vetëm çështjet të cilat janë në juridiksionin e PZAP-it. Prandaj bazuar në këtë nen të kësaj dispozitë ligjore saktësohet qartë se vetëm çështjet të cilat janë nën juridiksionin e PZAP-it duhet të shqyrtohen, prandaj pretendimet e parashtruara nuk bien nën juridiksionin e PZAP-it për të vendosur.

Prandaj, nga arsyet e paraqitura lart, në pajtim me nenin 13 paragrafi 3 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, si dhe nenit 119 paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke i hedhur poshtë ankesat si të palejueshme.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A.nr.1/2024, datë;03.09.2024



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 18 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.